Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BOD

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZ
Nr./Br. 643/20
Data/Datum 14.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

A.nr. 643/20

KRYESUESI I SEKRETARIATIT TË OSHP-së , në mbështetje të nenit 53, të Ligjit me nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative, bën anulonim të vendimit të OSHP-së, me nr. 643/20, të protokolluar me datë 10.09.2020, që ndërlidhet me procedurën e prokurimit: **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë",** me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, më datën 14.09.2020 mori këtë:

V E N D I M

I. **SHFUQIZOHET**, vendimi i OSHP-së, nr. 643/20, i protokolluar me datë 10.09.2020, që lidhet me procedurën e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë",** me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë.

II. **PEZULLOHET**, procedura e prokurimit në autoritetin kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull ""**Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë",** me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, deri në nxjerrjen e vendimit tjetër.

III. Organi Shqyrtues i Prokurimit do të vazhdoj me procedimin e ankesës së OE " **Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, me numër të protokollit 643/20, i protokolluar me datë 10.09.2020, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë",** me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-**

1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, në pajtim me nenin 113, 114, 116 dhe 117 të LPP-së.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, më datën 10.09.2020, përmes shkresës, ka kërkuar nga OSHP, korrigjimin dhe rishqyrtimin e vendimit të datës 10.09.2020, me numër te protokollit 643/20, duke u arsyetuar se ankesa e tyre është dorëzuar ne orarin zyrtar te punës mirëpo sistemi elektronik e-prokurimi e ka rritur për 4 minuta afatin e dorëzim pranimin e ankesave. Po ashtu anulim te vendimit te lartcekur ka kërkuar edhe Kryetari i OSHP-së.

OSHP , sqaron se me vendimin 643/20, te datës 10.09.2020, është vendosur qe te hedhet ankesa e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, si e jashtë afatshme ngase te gjitha shkresat qe zyrtaret e OSHP-së i kanë kontrolluar ne mënyrë elektronike, ka rezultuar se ankesa në fjalë është dorëzuar me datën 07.09.2020 ora 16:04.

Mirëpo OSHP vendimin e lartcekur e shfuqizon duke marr parasysh faktin se KRPP me datën 11.09.2020, si institucion kompetent për sistemin elektronik te E-prokurimit, ka sqaruar se ankesa e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, është krijuar me datën 07.09.2020 ora 15:38 minuta derisa është dërguar me datën 07.09.2020 në ora 16:00, dhe sqarojnë se paraqitja e kohës se dorëzimit te kësaj ankese me datën 07.09.2020 në ora 16:04 minuta është problem teknik apo çështje e sinkronizimit ne kohe te komponentëve te sistemit te prokurimit elektronik dhe ne te cilin është duke u punuar qe te rregullohet. Emailet notifikuese për dërgim te ankesës me numër 2020/0001140 janë pranuar në ora 16:00 nga te gjithë përdoruesit e ndërlidhur me ketë përdorim(OSHP AK).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, përkatësisht Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, pas pranimit të shkresës / për shfuqizim /anulim te vendimit 643/2020, te dt. 10.09.2020, i ka trajtuar dhe shqyrtuar me kujdes të njëjtat shkresa/ kërkesa dhe pas administrimit të të gjitha provave shkresore, ka konstatuar se ankesa e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, e dorëzuar në

mënyrë elektronike me datën 07.09.2020, ndërsa është protokolluar me datën 08.09.2020 me nr. të protokolli. 643/20, e parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, duhet te shqyrtohet për faktin se e njëjta është dorëzuar në OSHP brenda afatit ligjor.

Nga ana e OSHP-së për shkak sqarimeve të mangëta te dhëna nga palët në procedurë, gabimisht është hedhur si e jashtafatshme ankesën e OE **"Mirusha Company" SH.P.K. – Klinë**. Kjo ngatërresë ka ndodhur edhe për faktin se sistemi elektronik nuk e definon sekt kohen e dorëzimit te ankesës dhe ka qenë e pa qartë ora dhe minuta e dorëzimit te ankesës për shkak te problemeve teknike te sistemit ashtu siç ka sqaruar edhe KRPP-ja.

Organi Shqyrtuesi i Prokurimit sqaron se do të vazhdoj me procedimin e ankesës së OE **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**, me numër të protokollit 643/20, të dorëzuar në mënyrë elektronike me datën 07.09.2020, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat në Rugovë"**, me numër të prokurimit AP: **635-20-2895-5-1-1** dhe numër të brendshëm: **635-20-030-5-1-1**, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Pejë, në pajtim me nenin 113, 114, 116 dhe 117 të LPP-së. Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 53, të ligjit me nr. 05/L-031, Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe duke u bazuar në atë që u përshkrua si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Sekretariatit te OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Pejës

1x1 OE- **"Mirusha Company" SH.P.K. - Klinë**

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.